VENDIM
Nr. 147, datë 11.3.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 199, DATË 10.4.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRYETARIT DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE, PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT QENDROR, NË KËSHILLIN DREJTUES TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 199, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, znj. Belinda Balluku, zëvendëskryeministër, zëvendësohet me znj. Albana Koçiu, zëvendëskryeministër.

2. Në pikën 2, znj. Ana Kapaj, zëvendësministër i Arsimit, zëvendësohet me znj. Olta Manjani, zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama